



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**MBI KONKURSION E IX NDËRKOMBËTAR TË SHKENCËS DHE
TEKNOLOGJISË NË RUSI**

Ministria e Shkencës dhe Arsimit të Lartë të Federatës Ruse do të organizojë edicionin e IX të festivalit rus të shkencave me temë “*Shkencëtarët e së ardhmes*”. Ky festival është projekti më i madh në fushën e shkencës dhe teknologjisë që do të mbahet në Rusi me pjesëmarrjen e të rinjve, kryesisht nxënësve të shkollave të mesme të talentuar në fushën e fizikës, astronomisë, matematikës, kimisë, biologjisë dhe shkencave të jetës, programimit, gjeologjisë dhe shkencave të tokës, inxhinierisë, elektronikës, pajisjeve elektronike, programeve të internetit, modelimit 3D.

Përmes njoftimit bashkëlidhur, pala ruse fton të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në konkursin që do të organizohet me këtë rast. Konkursi ndërkombëtar, përmes punimeve shkencore dhe teknologjike, synon identifikimin e të rinjve, kryesisht nxënësve të shkollave të mesme të talentuar në fushën e shkencës, mbështet dhe inkurajon zhvillimin intelektual dhe të aftësive të tyre shkencore, si dhe do të adresojë vëmendjen e gjeneratave të reja në fushën e shkencës për zbatimin e projekteve të përbashkëta. Në konkursin ndërkombëtar “*Shkenca është magji*” do të prezantohen video deri në 3 minuta në të gjitha fushat e shkencës me demonstrime shkencore dhe eksperimente mbresëlënëse.

Gjithashtu, fituesit e konkursit do të kenë prioritet për t’u bashkuar me ekipin kombëtar rus në panairin shkencor të Pekinit, ku do të mbahet edhe konkursi rinor i formimit shkencor, si dhe konferenca ndërkombëtare e shkencëtarëve të rinj.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe kushteve që duhet të plotësojë kandidati, ju lutemi referojuni materialit informues bashkëlidhur, i cili gjendet gjithashtu në faqen zyrtare web:

<http://science-is-magic.festivalnauki.ru/eng>

e-mail: konkurs@festivalnauki.ru

Afati i fundit i aplikimit për pjesëmarrje në këtë konkurs ndërkombëtar është data **2 shtator 2019**, ndërsa faza finale e konkurrimit do të mbahet në Moskë në datat **11-13 tetor 2019**.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS